




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK  
 Nr. Prot. 01-1396/15  
 Br. Prot. 03  
 Data 21-05-2015  
 Nr. Eftaj  
 Broj stranica  
 Nr. pages  
 PS/SHITE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

|                        |                                                                                                               |
|------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATË/A:                | 19.05.2015                                                                                                    |
| REFERENC-Ë:            | AKK-DPKPP                                                                                                     |
| PËR/ZA/TO:             | z. Besar Maqedonci<br>Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Sekretariatit e Këshillit<br>Gjyqësor të Kosovës     |
| CC:                    | z. Albert Avdiu<br>Drejtor në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës                                   |
| NGA/OD/FROM:           | z. Hasan PRETENI<br>Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit                                                   |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me Tenderin me titull "Mirëmbajtja dhe<br>servisimi i klimave aktuale në objekte të gjykatave" |



**I nderuari z. Maqedonci,**

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin "Mirëmbajtja dhe servisimi i klimave aktuale në objektin e gjykatave" me numër prokurimi: 33300 15 019 221 Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "Mirëmbajtja dhe servisimi i klimave aktuale në objektin e gjykatave" me numër prokurimi: 33300 15 019 221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.



### *Arsyetim*

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës si Autoritet Kontraktues, përmes Zyrës për Prokurim ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull **"Mirëmbajtja dhe servisi i klimave aktuale në objekte të Gjykatave"** me numër prokurimi: 33300 15 019 221, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.21.04.2015 në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në të dhëna të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 21.04.2015 tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, kërkohet: Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku 1 kontratë të natyrës së ngjashme kërkesë e cila konsiderojmë se bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Sipas LPP-së, një Autoritet kontraktues mundet të kërkoj dëshmi me të cilat do ta vërtetonte Kapacitetin ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, atëherë kërkesat duhet t'i referohen maksimum tri viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Autoritetit Kontraktues nuk i lejohet në asnjë mënyrë që ti shmanget këtij kufizimi prej tri viteve.

AKK gjatë shfletimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar se në Dosjen e Tenderit tek Seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit në rubrikën 13.2-Siguria e Tenderit, autoriteti kontraktues ka kërkuar sigurinë e tenderit në vlerë prej 1,000.00€ me validitet 60 ditë, si dhe tek rubrika 22.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë 60 ditë.

Bazuar në legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik, siguria e tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues dot duhej që validitetin e sigurisë së tenderit ta kërkonte në periudhë prej 90 ditëve.

Autoriteti Kontraktues SKGJK më datë 15.05.2015 ka bërë kërkesë përmes postës elektronike duke ftuar Agjencinë kundër Korrupsionit të marrë pjesë në monitorimin e punës së komisionit për vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminim e ofertave. Gjatë monitorimit të komisionit vlerësues AKK konstaton se për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë dorëzuar gjithsej 4 Operatorë Ekonomik ku 3 nga këta janë të përgjegjshëm duke i plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, të cilët operator kanë ofruar referenca për punë të ngjashme të përfunduara gjate tri viteve të fundit (2012, 2013 dhe 2014), si dhe dy prej tyre kanë ofruar sigurinë e tenderit me validitet prej 90 ditëve duke përfshirë edhe Operatorin i cili ka ofertuar me çmimin më të lirë për këtë aktivitet të prokurimit .





Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin 26 Sigurimi i Tenderit të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Agjencia rekomandon autoritetin kontaktues që për aktivitet e prokurimit ne te ardhmen kërkesat financiare, teknike dhe profesionale ti përpilojë në pajtueshmëri me nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 dhe nenin 26 Sigurimi i Tenderit të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

OSQ  
\*  
OSQ